

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
Albanian Energy Supplier Sh.p.k.
Rruga Brigada e 8, Pallati 19, Kati 3, Ap.3, Tirane, Shqipëri,
Regjistruar pranë regjistrit tregtar me numër identifikimi
L42304017T

VENDIM

I

ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, me 07.02.2022 në selinë e Shoqërisë Albanian Energy Supplier Sh.p.k. (më tej referuar si "Shoqëria"), në datën u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë me të pranishëm:

- Shoqëria "**Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k**" Sh.p.k., një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me **NUIS K72223031K** dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 12, ABA Business Center, Tirane, Shqipëri, me administratore, znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, e lindur më 03.02.1983, në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 025864525, dhe me numër personal I35203147R, ortake e Shoqërisë dhe zotëruese e 100% të kapitalit themeltar të saj.
- Znj. Ada Gramatiku, ne cilësinë e konsulentit ligjor pranë Departamentit Ligjor te Balfin Sh.p.k.

Meqenëse në mbledhje merr pjesë Ortaku që përfaqëson 100% të kapitalit themeltar, Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë konsiderohet e mbledhur rregullisht dhe vendimet e marra plotësisht të vlefshme.

Znj. Edlira Muka, e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Ada Gramatiku, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit.

Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

Rend Dite

I. MIRATIMI I ZVOGELIMIT TË ZAKONSHËM TË KAPITALIT.

Në lidhje me çështjen e parë në Rend Dite, Kryetari i Asamblesë parashtron se kapitali i shoqërisë është 101.302.600 Leke (njëqind e një milion e treqind e dy mijë e gjashtëqind Lekë), dhe nisur nga një vlerësim paraprak konstatohet se Aktivitetet e Shoqërisë janë në nivele të atilla që mbulojnë më së miri kryerjen e aktivitetit të saj si normalisht dhe mbulimin e detyrimeve ndaj funitorëve. Nga sa më sipër është konsideruar e përshtatshme zvogëlimi i zakonshëm i kapitalit të Shoqërisë me një vlerë prej prej 95,302,600 LEK (nëntëdhjetë e pesë milion e treqind e dy mijë e gjashtëqind lekë). Pas zvogëlimit, kapitali i Shoqërisë nga vlera 101.302.600 Leke (njëqind e një milion e treqind e dy mijë e gjashtëqind Lekë) do të bëhet në një vlerë prej 6,000,000 LEK (gjashtë milion Lekë).

Rozan Koshin
Rozan

Pas një shqyrtimi të kujdesshëm të çështjes së parë në Rend të Ditës, Ortaku i Vetëm:

VENDOS:

- A. Të miratojë zvogëlimin e zakonshëm të kapitalit të Shoqërisë me një vlerë totale prej 95,302,600 LEK (nëntëdhjetë e pesë milion e treqind e dy mijë e gjashtëqind lekë).
- B. Pas zvogëlimit, kapitali themeltar i Shoqërisë do të bëhet në një vlerë prej 6,000,000 LEK (gjashtë milion Lekë).
- C. Të autorizojë administratorin e Shoqërisë për kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, personalisht apo nëpërmjet autorizimit të personave të tretë për këtë qëllim.


Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 13.30.

Ky Vendim i Asamblesë së Ortakut të Vetëm të "Albanian Energy Supplier" Shpk mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË

ALBANIAN ENERGY SUPPLIER SH.P.K

KRYETARI



Znj. Edlira MUKA

Administratore

Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.



SEKRETARI


Znj. Ada Gramatiku

